

## B.E.K.O.J. (java 2 nga 6)

### Java 2 - B – Bjer në gjunjët e lutjes

Ideja e madhe: Për të arritur, restauruar dhe riprodhuar, ne fillojmë duke u lutur se kë dëshiron Perëndia që ne të bekojmë çdo ditë dhe se si Ai veçanërisht dëshiron që ne si individë të bekojmë botën tonë.

Ne po vazhdojmë serinë "B.E.K.O.J." dhe shpresa ime për të gjithë ju është kjo: të zbuloni se çfarë "DUHET" të bëni! Nëse ishe këtu javën e kaluar, ne folëm se si jeta është e mbushur me kaq shumë gjëra që ne "duhet" të bëjmë – të njëjtat gjëra të vjetra. Por unë besoj se kur Zoti të lindë, ai të lindë me një ëndërr dhe diçka që ti dhe vetëm ti "DUHET" ta bësh! Një shkak! Një mision!

#### ARRITJE, RESTAURIM, RIPRODHIM

Si një ndjekës i Krishtit, pika fillestare për të zbuluar misionin tënd është të kuptuarit e misionit të atij që ne ndjekim, Jezusit. Misioni i Jezusit mund të kuptohet me 3 fjalë:

- Arritje – arritja e njerëzve larg Perëndisë. Shumica e njerëzve në këtë qytet janë larg Zotit. Jezusi i tha "Shkoni në gjithë botën" (Mateu 28:19) dhe ne po e pranojmë sfidën që të "shkojmë" dhe të jemi një popull që do të arrijë njerëzit që janë larg Perëndisë.
- Restaurim – restauro ëndrrën e Perëndisë për këtë botë. Si ndjekës të Krishtit, ne nuk mund të flasim më vetëm për varfërinë dhe të tundim kokën për çështjet e padrejtësisë, ne duhet të ndërmarrim veprime për t'i trajtuar ato çështje. Jezusi tha: "Perëndia më ka vajosur për t'u sjellë lajmin e mirë të varfërve." (Luka 4:18) Kjo ishte një pjesë e misionit të Jezusit dhe duhet të jetë pjesë e misionit tonë; për të restauruar ëndrrën e Zotit për botën.
- Riprodhim – riprodhoni misionin tek të tjerët. Për shkak se vizioni i Jezusit ishte të shihte misionin e tij të përhapur nga "Jerusalemi... Judea... Samaria... dhe deri në skajet e tokës" (Veprat e Apostujve 1:8) për të përmbushur atë vizion, ne jo vetëm që duhet ta bëjmë misionin, por ne duhet gjithashtu të praktikojmë dhe riprodhojmë misionin tek të tjerët.

Dhe kur i bashkon të gjitha, ky është Misioni i Jezusit; kjo është mënyra se si ti "i ndihmon njerëzit të gjejnë rrugën e tyre për t'u kthyer te Perëndia". Kjo është arsyeja pse ka qenë gjithmonë dhe do të jetë gjithmonë misioni i kishës. Por ja çfarë duhet të ndryshojë: kjo NUK është vetëm një deklaratë misioni që duhet ditur! Kjo NUK është vetëm deklarata e misionit të kishave. Ky është misioni juaj! Diku këtu është misioni juaj i jetës; arsyeja pse Zoti ju krijoi; qëllimi i jetës suaj.

#### STRATEGJIA E BEKIMIT

Që nga fillimi, shumë prapa në librin e parë të Biblës, Zanafilla, mënyra e Zotit për të ndryshuar botën ka qenë përmes një strategjie bekimi. Te Zanafilla, kapitulli 12, Perëndia i thotë Abrahamit: “2. Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. 3. Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë, te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës". (Zanafilla 12:2, 3). Perëndia e bekoj Abrahamin (në familje, financiarisht dhe shpirtërisht), por qëllimi i atij bekimi nuk ishte që ai thjesht ta merrte atë bekim. Qëllimi i bekimit për Abrahamin dhe të gjithë ata që e ndoqën, duke përfshirë Jezusin dhe ne - **po bekohemi që të JEMI bekim (2x)**

Le të ndalojmë për një sekondë

- nëse nuk e kupton këtë, nuk do ta zbulosh kurrë misionin tënd në jetë DHE asgjë tjetër që do të them për pjesën tjetër të kësaj serie nuk do të ketë kuptim: çdo gjë e mirë në jetën tënde, çdo bekim,
- ti je bekuar që jesh bekim për të tjerët!

Të qenit një bekim për njerëzit është edhe mënyra se si e përmbush misionin e Jezusit, edhe si e zbulon misionin tënd. E kuptove? Nëse po, atëherë mendoje pak këtë, "Si duket të bekosh njerëzit ose të jesh një 'bekim'?" Pyetje e madhe!

B.E.K.O.J.

Përgjigja për këtë pyetje është 5 praktika misioni që do të ndajmë gjatë këtyre pesë javëve. Këto praktika përbëjnë akronimin BEKOJ...B-E-K-O-J. Tani, përpara se të ndaj të parën - më lejo të them vetëm se disa prej jush mund të tundohen që të bëjnë një listë me këto praktika, që t'i mbarojnë të gjitha dhe të mund të thonë, "U krye. I mbarova. Tani jam në rregull!" Ti nuk i bekon njerëzit kështu...

Nuk funksionon kështu! Nëse thjesht po përpiqesh t'i mbarosh, në mënyrë që të mund të thuash se e ke përfunduar listën, nuk po bëhesh një bekim për të tjerët.

Tani, tundimi tjetër është të hedhësh poshtë këto 5 praktika misioni sepse duken shumë të thjeshta. Të lutem, mos e bëj atë gabim!

(shënim për pastorin:

opsionale:

*Kjo seri do jetë me life-story të ndryshme (të lidhura drejtpërdrejt me mesazhin)  
\*këtë javë lidheni me lutjen, çfarë impakti ka lutja\**

*Life-story, djali/vajza. )*

## B – Bjer në gjunjët e lutjes

Praktika e parë e misionit është B – Bjer në gjunjët e lutjes.

### JEZUSI FILLON ME LUTJE

Jo vetëm që Jezusi e filloi ditën e tij me lutje; kështu Jezusi e filloi shërbesën e tij -- me lutje. Tek Luka 4:1 thuhet: “Dhe Jezusi, plot me Frymën e Shenjtë, u kthye nga Jordani dhe Fryma e çoi në shkretëtirë,”. Jezusi shkoi në shkretëtirë për të agjëruar, për t'u lutur dhe për t'u përballur me të ligun - lutja ishte mënyra se si ai filloi misionin e tij në tokë.

Dhe dy kapituj më vonë, kur Jezusi po bëhet gati për të zgjedhur ata që do t'i bashkohen atij në këtë mision, shikoni çfarë thotë Luka 6 se ai bën:

“12. Në ato ditë ndodhi që ai shkoi në mal për t'u lutur, dhe e kaloi natën duke iu lutur Perëndisë.

13. Dhe kur zbardhi dita, thirri pranë vetes dishepujt e vet dhe zgjodhi prej tyre dymbëdhjetë, të cilëve u dha edhe emrin apostuj:

14. Simonin, të cilit i vuri emrin Pjetër, dhe Andrean, vëllanë e tij, Jakobin e Gjonin, Filipin dhe Bartolomeun,

15. Mateun dhe Thomanë, Jakobin e Alfeut dhe Simonin, që e quanin Zelota,

16. Judën, vëllanë e Jakobit dhe Judën Iskariot, i cili u bë tradhtar.”.

(Luka 6:12-16) Tani, nëse do të kisha qenë unë, mund të isha tunduar të kapërceja pjesën e lutjes dhe të zgjidhja vetëm disa nga udhëheqësit që binin më në sy. Mendoni se nuk kishte disa zgjedhje të dukshme? Sigurisht që kishte! Por Jezusi nuk bën vetëm atë që ka kuptim për Të; Ai e kalon natën në lutje përpara se të zgjedhë të 12-t. Këta persona do të ishin të parët që Ai do të dërgonte për të bekuar botën në misionin e Tij.

E shihni, ka qenë gjithmonë ëndrra e Perëndisë për të bekuar botën nëpërmjet popullit të Tij dhe fillimisht, njerëzit e Tij ishin dymbëdhjetë fiset e Izraelit të lashtë. Por gjatë rrugës, ata vazhduan të përqendroheshin te vetja, te nevojat e tyre dhe te statusi i tyre si populli i zgjedhur i Perëndisë. Ata nuk e kuptonin misionin - nuk ishte vetëm që ata të bekoheshin, por që të ishin një bekim!

Por Perëndia nuk heq dorë nga ëndrra e Tij për të arritur dhe restauruar botën. Dhe me përzgjedhjen e 12 apostujve, Jezusi po restauron misionin e Perëndisë në botë duke zgjedhur dymbëdhjetë përfaqësues të rinj misionarë. Shumë studiues thonë se këta 12 njerëz (të cilët janë të gjithë anëtarë të dymbëdhjetë fiseve origjinale) janë disi si zëvendësuesit për dymbëdhjetë fiset. Perëndia po fillon nga e para, duke rinovuar planin e Tij për 12 fiset nëpërmjet këtyre 12 apostujve.

Tani, disa prej jush mund të pyesin veten: "Pse Jezusi kishte nevojë të lutej nëse Ai është Perëndi?" Pyetje e mirë! Shiko, edhe pse Jezusi ishte Perëndi në mish, të bëheshe qenie njerëzore do të thoshte të merrje kufizime të vetë-imponuara. Bibla thotë se Ai e di se si është të jesh ne, të jesh në vendin tonë; dhe kështu Ai u bë shumë më i ngjashëm me ne sesa e kemi imagjinuar ndonjëherë shumica prej nesh. Edhe si Perëndi në mish, Ai mbështetej te Perëndia Atë dhe kërkonte drejtim nga Ai.

Tani, ne nuk e dimë se çfarë ndodhi atë natë dhe herët në mëngjes që Ai filloi me lutje.

- A i foli Perëndia Atij me një zë të dëgjueshëm dhe filloi të emëronte emra?
- A i dolën në kokë disa emra apo kishte ndonjë shenjë?

Ne nuk e dimë. Ne dimë vetëm se përpara se Jezusi të fillonte misionin e Tij për të bekuar botën, Ai filloi me lutje.

Dhe është interesante të theksohet se djemtë që Jezusi zgjodhi pas lutjes nuk ishin zgjedhjet që do kishin kuptim për një formacion fillestar. Ata ishin...

- ...peshkatarë të zakonshëm.
  - ...taksambledhës të korruptuar.
  - ...disa revolucionarë politike të dhunshëm.
  - ...dhe shumë prej tyre ishin thjesht 'askush'. Njerëz që ishin si të padukshëm.
- Por Jezusi filloi me lutje.

Lutja është edhe mënyra se si e kryen misionin, edhe si e zbulon misionin tënd!

Siç thamë javën e kaluar – qëllimi ynë numër 1 për këtë vit si kishë është ky: që secili prej jush të ketë një histori misioni për të treguar. Që ti dhe unë do të kemi një histori në këtë vit se si Zoti na përdori në misionin e Tij për të bekuar dhe ndryshuar botën!

## PËRFUNDIM DHE SFIDË

Ok, do ta mbyll me një sfidë. Gati? Gjatë 5 javëve të ardhshme ne do të parashtrijmë këto 5 sfida misioni - B.E.K.O.J. Sfida është kjo:

- Çdo ditë: Bëj një nga këto çdo ditë. Dhe meqenëse e vetmja që di deri tani është B - **Bjer në gjunjët e lutjes**, fillo me lutje. Unë dua që të fillosh çdo ditë derisa të mblidhemi përsëri këtu duke u lutur: "Zot, më përdor për të bekuar botën tënde. Më bëj pjesë të misionit tënd. Më bëj të qartë misionin tënd. Zot, më përdor për të bekuar dikë sot."

- Çdo javë: Kur mblidhesh me grupin tënd të vogël, fillo grupin duke pyetur: "Kë bekove ti këtë javë?"

Në rregull? Kjo është sfida. Çdo ditë ne lutemi: "Zot, më përdor për të bekuar dikë sot." Dhe çdo javë te grupi i vogël pyesni njëri-tjetrin: "Kë bekove këtë javë?"

Dhe le të fillojmë që tani. Si? Duke filluar me lutjen. Unë do të lutem me zë të lartë dhe ti mund të lutesh në heshtje.

**Le të lutemi**